



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

# Raport Vlerësimi

Shqyrtimi i tetë i tarifave të energjisë elektrike

ETR8 (2014-2015)

Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale dhe Ngarkesave të  
Gjeneratorit të Rregulluar

**16 maj 2014**

## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Përshatjet e Rregullta .....</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Balanca e Energjisë .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>4</b>	<b>Vlerësimi i ZRRE-së për MAR të Gjeneratorit të Rregulluar .....</b>	<b>3</b>
4.1	Vlerësimi i ZRRE-së për Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMct).....	3
4.1.1	Norma e aplikueshme e inflacionit.....	4
4.1.2	Faktori i aplikueshëm i efikasitetit.....	4
4.1.3	Aplikimi i E-faktorit në OTFct .....	4
4.1.4	Vlerësimi final i ZRRE-së për OPMct .....	5
4.2	Vlerësimi i ZRRE-së për Zhvlerësimin e Lejuar (DEPct).....	5
4.3	Vlerësimi i ZRRE-së për Kthimin e Lejuar (RTNct).....	6
4.4	Vlerësimi i ZRRE-së për Kostot e Blerjes së Thëngjillit (LGScT) .....	7
4.5	Vlerësimi i ZRRE-së për Kostot e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFct) .....	7
4.6	Vlerësimi i ZRRE-së për Kostot e Tjera qe Barten (PSTct).....	7
4.7	Përditësime të tjera për Gjeneratorin e Rregulluar .....	8
<b>5</b>	<b>Vlerësimi i ZRRE-së për MAR të Gjeneratorit të Rregulluar .....</b>	<b>8</b>



## **1 Hyrje**

Zyra e Rregullatorit për Energji është në procesin e shqyrtimit të tetë të tarifave të energjisë elektrike. Në këtë proces bëhet Azhurnimi Vjetor i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike si dhe Përshtatja e Rregullt e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar (KEK), Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim (KEDS).

Ky raport paraqet vlerësimin e ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) të Gjenerimit. Krahas këtij Raporti, ZRRE do të publikojë edhe vlerësimin për MAR të KOSTT-it, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE).

## **2 Përshtatjet e Rregullta**

Në 2013 Zyra e Rregullatorit për Energji ka përfunduar procesin e Shqyrtimit Periodik (SHTE7) sipas të cilit janë caktuar të Hyrat Maksimale të Lejuara për katër vitet e ardhshme relevante të Gjeneratorit të Rregulluar (KEK), ndërsa për pesë vitet e ardhshme relevante të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Të Hyrat Maksimale të Lejuara të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE) ishin caktuar për periudhë një vjeçare gjatë shqyrtimit të Vlerave Hyrëse sipas Rregullës për Vendorsjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike.

Sipas Rregullës për Vendorsjen e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, pas përfundimit të çdo Viti Relevant të Periudhës Rregullative 5 vjeçare, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duhet të bëjë Përshtatjet e Rregullta për Gjeneratorin e Rregulluar. Përshtatjet e Rregullta dallojnë nga Shqyrtimet e plota Periodike ngase nuk përfshijnë analizimin e detajuar të shpenzimeve të lejuara operative e kapitale të Gjeneratorit të Rregulluar. Gjatë këtyre përshtatjeve, ZRRE bën vetëm llogaritjet mekanike për të reflektuar inflacionin vjetor të shpenzimeve, indeksimin e shpenzimeve operative për faktorin e efikasitetit si dhe përditësimin e shpenzimeve të tjera për të reflektuar ndryshimin në mes të vlerës së tyre të parashikuar dhe të realizuar.

Gjatë kësaj Përshtatjeje të Rregullt, ZRRE do të:

1. Indeksojë kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes të Gjeneratorit të Rregulluar për të reflektuar Faktorin e Efikasitetit të caktuar gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për të Gjitha Njësitë në Eurozonë;
2. Përditësojë Kostot e Lejuara të Blerjes së Thëngjillit (LGSCt) të Gjeneratorit të Rregulluar;
3. Përditësojë Kostot e Lejuara të Blerjes së Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFct) të Gjeneratorit të Rregulluar;
4. Përditësojë Kostot e Tjera që Barten (PSTct)
5. Caktojë Cakun e Disponibilitetit të Gjeneratorit të Rregulluar;
6. Caktojë ngarkesën për Energji dhe Ngarkesën për Kapacitet të Gjeneratorit të Rregulluar.



Ky Raport është strukturuar si më poshtë:

- Seksioni 3 paraqet vlerësimin e ZRRE-së për aplikacionin e Gjeneratorit të Rregulluar;
- Seksioni 4 paraqet një përmbledhje të vlerësimeve të ZRRE-së për aplikacionin e Gjeneratorit të Rregulluar;

### 3 Vlerësimi i ZRRE-së për MAR të Gjeneratorit të Rregulluar

Gjatë Përshtatjeve të Rregullta ZRRE përcakton ndryshimin e lejuar të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të Gjeneratorit të Rregulluar. Ky ndryshim i të Hyrave do të llogaritet sipas formulës së dhënë në Paragrafin 2 të Shtojcës 1 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LGSC_t + OTFC_t + PSTC_t$$

*Ku*

$MAR_t$  paraqet Të hyrat e Lejuara Maksimale në Vitin Relevant  $t$

$OPMC_t$  paraqet Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant  $t$

$DEPC_t$  paraqet Zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant  $t$

$RTNC_t$  paraqet Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant  $t$

$LGSC_t$  paraqet Kostot e lejuara të furnizimit të thëngjillit në vitin relevant  $t$

$OTFC_t$  paraqet Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant  $t$

$PSTC_t$  paraqet Kostot e bartshme në vitin relevant  $t$

#### 3.1 Vlerësimi i ZRRE-së për Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMCt)

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes të Gjeneratorit të Rregulluar rivendosen gjatë çdo përshtatjeje Vjetore sipas formulës në vijim (Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, Shtojca 1, paragrafi 2.1):

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

*Ku*

$OPMC_t$  paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant  $t$

$OPMC_{t-1}$  paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant  $-t-1$ , përveç vitit relevant  $1$ , ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik



$CPI_{t-1}$	<i>paraqet Vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, të matur duke përdorur “Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën” të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë masë tjetër e inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që lejohet gjatë shqyrtimit periodik</i>
$E_t$	<i>paraqet Faktorin e efikasitetit në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik dhe i cili është caktuar nga ZRRE të jetë 4%</i>
$P_t$	<i>paraqet Faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik dhe i cili është caktuar të jetë zero.</i>

### **3.1.1 Norma e aplikueshme e inflacionit**

KEK ka propozuar që norma e aplikueshme e inflacionit të jetë 0.7%, që në kohën e dorëzimit të aplikacionit të tyre paraqiste normën e inflacionit të muajit tetor 2013, të vlerësuar sipas Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit për të Gjitha Njësitë në Eurozonë.

ZRRE ka rivlerësuar normën e aplikueshme të inflacionit për indeksimin e MAR të Gjeneratorit të Rregulluar sipas të dhënave më të vonshme për inflacionin vjetor të dhëna në ueb-faqen e Eurostat-it. Norma e aplikueshme e inflacionit për muajin shkurt 2014 rezulton të jetë 0.7%<sup>1</sup>.

### **3.1.2 Faktori i aplikueshëm i efikasitetit**

KEK ka propozuar reduktim të faktorit të aplikueshëm të efikasitetit operativ nga 4% - sa ishte caktuar nga ZRRE – në 1%. KEK arsyeton propozimin e tyre me faktin se një pjesë e konsiderueshme e stafit të kualifikuar të KEK tashmë është pjesë e KEDS dhe se është e vështirë të zëvendësohet stafi i kualifikuar me pagat më të ulëta të KEK-ut krahasuar me akterët e tjerë në sektor. Propozimi i tyre poashtu është bazuar në argumentin se KEK ngarkohet me barrën sociale të mbajtjes së punëtorëve pavarësisht faktit se ZRRE supozon operimin komercial të saj.

ZRRE thekson se Faktori i Efikasitetit caktohet gjatë Shqyrtimit Periodik për tërë gjatësinë e Periudhës Rregullative për t'i mundësuar operatorëve të implementojnë plane afatgjata për përmirësimin e efikasitetit operativ prandaj mos-arritja e këtij caku në Vitin e parë Relevant nuk nënkupton medoemos se caku nuk është i arritshëm përgjatë Periudhës Rregullative. Rrjedhimisht ZRRE do të vazhdojë të aplikojë faktorin e efikasitetit prej 4% në indeksimin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes.

### **3.1.3 Aplikimi i E-faktorit në OTFCT**

Në propozimin e tyre për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin e dytë Relevant, KEK ka vlerësuar se gjatë aplikimit të faktorit të efikasitetit për Vitin e parë Relevant ZRRE ka përfshirë në llogaritjen e

---

<sup>1</sup> <http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/refreshTableAction.do?jsessionid=9ea7d07d30e7a2a0d00a3622451d993b94fd5b2e0b51.e340aN8PchaTby0Lc3aNchuMchmMe0?tab=table&pcode=teicp000&language=en>



OPMct-së edhe shpenzimet e lëndëve të tjera djegëse (OTFct) e të cilat, sipas formulës së dhënë në paragrafin 2 të shtojcës 1 të Rregullës, nuk do të duhej të ishin përfshirë. Aplikimi i faktorit të efikasitetit prej 4% në Shpenzimet e tjera për lëndë djegëse prej €8.3 milionë ka rezultuar në nënvlerësim të MAR-it të KEK-ut prej €0.3 milionë.

ZRRE pranon propozimin e KEK-ut dhe ka përshtatur të Hyrat Maksimale të Lejuara për vitin e dytë Relevant për të reflektuar azhurnimin e lartshënuar.

### 3.1.4 Vlerësimi final i ZRRE-së për OPMct

Formula për llogaritjen e Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes, e dhënë në paragrafin 2.1 të Shtojcës 1 të Rregullës, supozon se lejesa e OPMct profilizohet përgjatë periudhës Rregullative ashtu që OPMct e një viti të caktuar relevant të llogaritet duke indeksuar vlerën e OPMct-së të vitit paraprak relevant. Meqë ZRRE nuk ka profilizuar OPMct-në gjatë Shqyrtimit Periodik (bazuar në konsultimet me të gjithë palët e interesit gjatë shqyrtimit tarifar SHTE7), aplikimi i drejtpërdrejtë i formulës së lartpërmendur do të rezultonte në vlera që nuk përkojnë me lejesat vjetore të OPMct-së përgjatë të gjitha viteve Relevante të Periudhës Rregullative. Për të azhurnuar këtë, ZRRE do të aplikojë formulën në vijim:

$$OPMC = OPMC_{t-1} * (CPI_{t-1}) * (1 - E_t) + OPMC_t$$

Shpenzimet e Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes të Gjeneratorit të Rregulluar për Vitin e dytë Relevant rezultojnë të jenë €20.9 milionë.

### 3.2 Vlerësimi i ZRRE-së për Zhvlerësimin e Lejuar (DEPct)

Zhvlerësimi i Lejuar i Gjeneratorit të Rregulluar rivendoset në çdo përshtatje të Rregullt sipas paragrafit 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës:

$$DEPct = DEPct_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku:

$DEPct$	<i>Paraqet zhvlerësimin tjetër të lejuar në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative</i>
$DEPct_{t-1}$	<i>paraqet zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore</i>
$CPI_{t-1}$	<i>paraqet vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i</i>
$P_t$	<i>paraqet faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike</i>

Si në rastin e Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes, formula për llogaritjen e DEPct, e dhënë në paragrafin 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës, supozon se vlera e lejuar e DEPct profilizohet përgjatë



periudhës Rregullative ashtu që DEPCt e një viti të caktuar relevant të llogaritet duke indeksuar vlerën e DEPCt-së të vitit paraprak relevant. Meqë ZRRE nuk ka profilizuar DEPCt-në gjatë Shqyrtimit Periodik, aplikimi i drejtpërdrejtë i formulës së lartpërmendur do të rezultonte në vlera që nuk përkojnë me lejesat vjetore të DEPCt-së përgjatë të gjitha viteve Relevante të Periudhës Rregullative. Për të përditësuar këtë, ZRRE do të aplikojë formulën në vijim:

$$DEPC = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t$$

Zhvlerësimi i lejuar për vitin e dytë relevant rezulton të jetë €22.3 milionë.

### 3.3 Vlerësimi i ZRRE-së për Kthimin e Lejuar (RTNCt)

Kthimi i lejuar është llogaritur sipas formulës së dhënë në paragrafin 2.3 të Shtojcës 1 të Rregullës:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

*Ku*

*RTNC<sub>t</sub>*                    Është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative

*RTNC<sub>t-1</sub>*                    Është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore

*CPI<sub>t-1</sub>*                    është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i

*P<sub>t</sub>*                            është faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik

Si në rastin e Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes dhe atë të Zhvlerësimit të Lejuar, formula për llogaritjen e RTNCt, e dhënë në paragrafin 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës, supozon se vlera e lejuar e RTNCt profilizohet përgjatë periudhës Rregullative ashtu që RTNCt e një viti të caktuar relevant të llogaritet duke indeksuar vlerën e RTNCt-së të vitit paraprak relevant. Meqë ZRRE nuk ka profilizuar RTNCt-në gjatë Shqyrtimit Periodik, aplikimi i drejtpërdrejtë i formulës së lartpërmendur do të rezultonte në vlera që nuk përkojnë me lejesat vjetore të RTNCt-së përgjatë të gjitha viteve Relevante të Periudhës Rregullative. Për të korrigjuar këtë, ZRRE do të aplikojë formulën në vijim:

$$RTNC = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_t$$

Kthimi i Lejuar për Gjeneratorin e Rregulluar rezulton të jetë €8.8 milionë.



### **3.4 Vlerësimi i ZRRE-së për Kostot e Blerjes së Thëngjillit (LGSCt)**

Në mungesë të marrëveshjes së furnizimit me thëngjill, kostot e lejuara të blerjes së thëngjillit nga Gjeneratori i Rregulluar janë llogaritur në bazë të të njëjtave parime si ato të Gjeneratorit, në pajtim me Nenin 11 të Rregullës për Vendorsen e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar.

Vlerësimi i ZRRE-së për shpenzimet e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes në Divizionin e Minierave për Vitin e dytë Relevant është €37.3 milionë. Zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar janë vlerësuar në nivel prej €14.2 milionë dhe €9.3 milionë, respektivisht.

Kostot e blerjes së thëngjillit po ashtu janë përditësuar për të reflektuar ndryshimet në mes të vlerave të lejuara dhe atyre të realizuara. Një përmbledhje e këtyre përditësimeve është dhënë në vijim:

- Kostoja e lejuar për pagesën e tantumës së linjtit është përditësuar për të reflektuar dallimin në mes të vlerës së parashikuar në vitin e kaluar Relevant prej €25.6 milionë dhe vlerën e realizuar të kësaj kostoje prej €24.4 milionë. Diferenca prej €1.2 milionë është përditësuar me interes. Vlera përfundimtare e lejuar për kostot e tantumës për vitin e ardhshëm Relevant është €24.5 milionë.
- Gjatë përcaktimit të MAR për pesë vitet e shqyrtimit periodik, Gjeneratori i Rregulluar nuk ka deklaruar shitjet e thëngjillit nga Miniera në vlerë prej €2.1 milionë. Kjo vlerë është përditësuar me interes. Vlera e planifikuar e shitjes së thëngjillit për vitin e dytë Relevant është €1.8 milionë.
- Alokimi i kostos së administratës qendrore, sipas marrëveshjes në mes të KEDS dhe KEK, që i alokohet Divizionit të Minierave është €1.6 milionë.

Shuma totale e përditësimeve të lartpërmendura pas aplikimit të normës së interesit është €6.1 milionë.

Vlera e lejuar e kostos së blerjes së thëngjillit për Gjeneratorin e Rregulluar është €79.3 milionë.

### **3.5 Vlerësimi i ZRRE-së për Kostot e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFCT)**

Gjatë çdo përshtatjeje të Rregullit, ZRRE përditëson ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe atyre të realizuara të blerjes së lëndëve të tjera djegëse (OTFCT). Kostoja totale e blerjes së lëndëve të tjera djegëse e lejuar për Vitin e parë Relevant ishte €8.2 milionë ndërsa kostoja e realizuar ishte €6.5 milionë. Ndryshimi prej €1.7 milionësh do të zbritet nga MAR i Gjenerimit në vitin e dytë Relevant me interes. Vlera totale e kostove të blerjes së lëndëve të tjera djegëse për vitin e dytë Relevant, pas përditësimeve, është €6.28 milionë.

### **3.6 Vlerësimi i ZRRE-së për Kostot e Tjera qe Barten (PSTCt)**

ZRRE vlerëson se kostot që barten të gjeneratorit të Rregulluar për pagesat ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të sistemit janë €2.9 milionë.





### **3.7 Përditësime të tjera për Gjeneratorin e Rregulluar**

MAR i Gjeneratorit të Rregulluar për Vitin e ardhshëm Relevant është përditësuar për të reflektuar çështjet e mëposhtme:

- Alokimi i kostos së administratës qendrore, sipas marrëveshjes në mes të KEDS dhe KEK. Vlera që i alokohet KEK Gjenerimit është €0.8 milionë.
- Vlera e shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes është rritur për të reflektuar rritjen e kostos së sigurimit shëndetësor për punonjësit e KEK. Kjo është reflektuar si rritje në MAR të KEK-ut në vlerë prej €1.4 milionë.
- MAR është reduktuar për €0.2 milionë për të reflektuar të hyrat e KEK Gjenerimit nga shitja e avullit.
- MAR është reduktuar për €0.1 milionë për të reflektuar të hyrat e KEK Gjenerimit nga shitja e hirit.
- MAR është reduktuar për €0.4 milionë për të reflektuar të hyrat e tjera të KEK Gjenerimit.
- MAR është rritur për €0.8 milion të reflektuar energjinë të cilën e konsumojnë Divizioni i Prodhimit të Qymyrit (DPQ) për vitin 2013.

KEK kërkon aplikimin e Faktorit të përshtatjes së të Hyrave (KREV) për ndryshiminë mes të Hyrave Maksimale të Lejuar dhe të realizuar për vitin 2012. Me aplikim nuk ka dorëzuar provat shtesë për këtë kërkesë..

ZRRE nuk ka bërë Përshtatjet e të Hyrave Maksimale të lejuara pasi që KREV është vlerësuar gjatë SHTE 7 dhe refuzuar në mungesë të provave relevante të mjaftueshme që të ngarkohen konsumatorët, kurse KEK kundër Vendimit të ZRRE ka iniciuar shqyrtimin gjyqësor. Për një çështje të vendosur nuk mund të vendoset dy here përpos nëse Gjykata kompetente vendos ndryshe me një Aktgjykim meritor.

## **4 Vlerësimi i ZRRE-së për MAR të Gjeneratorit të Rregulluar**

Vlerësimi i ZRRE-së për të Hyrat Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar për vitin e dytë Relevant është €139.5milionë.

Tabela në vijim përmbledh krahasim të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe kërkuara për KEK SHA, me komponentët kryesorë të shpenzimeve operative & mirëmbajtjes zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar pas përshtatjeve të e rregullta të kostove vjetore.



Kategorit e kostove të MAR-it			MAR-i 2013	MAR-i 2014
Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes(O&M)	Euro	OPMct	22,740,755	20,897,514
Zhvlerësimi i llogaritur	Euro	DEPct	21,047,568	22,300,881
Kthimi në ekuitet	Euro	RETnt	7,996,863	8,767,760
Kostoja e furnizimit me lignit e lejuar	Euro	LGSCt	87,785,887	76,845,845
Kostot e lëndëve tjera djegëse të lejuara	Euro	OTFCt	8,261,669	6,283,322
Kostot e bartura (Pass through)të lejuara	Euro	PSTCt	2,858,134	3,465,598
Te hyrat nga hiri	Euro			-129,424
Korigjimi i vlerës së kostove të lëndëve djegëse tjera	Euro			330,467
Alokimi i kostove të AQ sipas marveshjes KEK KEDS	Euro			-797,007
Te hyrat nga avulli 2013	Euro			-172,968
Sigurimi shëndetësor 2013	Euro			537,814
Tjera	Euro			-434,669
Sigurimi shëndetësor 2014	Euro			935,250
Përshtatjet për konsumin nga Divizioni i Prodhimit të Qymyrit (DPQ).				808,942
<b>Të hyrat maksimale të lejuara TC "A&amp;B"</b>	<b>Euro</b>	<b>MARt</b>	<b>150,690,876</b>	<b>139,535,183</b>

## 5 Struktura e ngarkesave për energji dhe kapacitet për KEK- Gjenerimin

ZRRE duke u bazuar në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit si dhe Metodologjinë e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar, ka alokuar Të Hyrat e Lejuara Maksimale për KEK Sh.A. në Kosto Fikse të cilat mbulohen përmes ngarkesave për kapacitet dhe në Kosto Variabile të cilat mbulohen përmes ngarkesave për energji.

Struktura e ngarkesave për energji dhe kapacitet që do të zbatohet për vitin relevant tarifor është dhënë në tabelën në vijim.

Struktura e ngarkesave	Njësia	Ngarkesa
Ngarkesat për kapacitet	€/MW/h	18.63
Ngarkesa për energji	€/MWh	7.99